



REPUBLIKA E KOSOVËS AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. _____	Nr. Prot. _____
Dep. <u>DPK</u>	Br. Prot. <u>03-02/4762/16</u>
Dep. _____	Prot No. _____
Nr. i faq. _____	Data _____
Broj stranica <u>02</u>	Datum <u>16.12.2016</u>
Nr. pages _____	Date _____
PRISHTINË	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 09.12.2016, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-3389/16, për zyrtarin e lartë z. Gëzim Tosuni, Dekan i Fakultetit Ekonomik në Universitetin "Kadri Zeka" në Gjilan, për shkak se i njëjti ka dhënë dorëheqje nga funksioni publik dhe me këtë veprim zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të Interesit dhe mospajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-3389/16, qe për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Gëzim Tosuni, Dekan i Fakultetit Ekonomik, në Universitetin "Kadri Zeka" Gjilan.

Gjatë zhvillimit të procedurës për identifikimin e rasteve të konfliktit të interesit apo mos pajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik është vërejtur se zyrtari i lartë z. Gëzim Tosuni, Dekan i Fakultetit Ekonomik, në Universitetin "Kadri Zeka" në Gjilan, figuron si person i autorizuar në dy biznese private e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të mundshëm të interesit dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese zyrtari i lartë z. Gëzim Tosuni, ka ardhur ne zyrat e AKK-së, për tu njoftuar për situatën dhe nga zyrtarët e AKK-së, është njoftuar me çështjen e iniciuar për konflikt të mundshëm të interesit.

z. Tosuni, gjatë takimit është pajtuar me faktet e prezantuara dhe është deklaruar se nuk ka pasur njohuri lidhur me situatën e mundshme të konfliktit të interesit, dhe është zotuar se do ti ndërmarr të gjitha hapat e nevojshëm qe të shmang konfliktin e mundshme te interesit apo mos pajtueshmërinë me ushtrimin e funksionit publik.

Agjencia kundër Korrupsionit pas takimit qe ka pasur me zyrtarin në fjalë ka kontaktuar prapë me të dhe nga aji është njoftuar se ka probleme teknike pasi qe pronarët e njërit biznes ku është person i autorizuar gjenden jashtë vendit.

Duke parë qe kjo procedurë po vonohet Agjencia kundër Korrupsionit i ka dërguar edhe shkresën e dytë paralajmëruese ku e ka paralajmëruar zyrtarin z. Gëzim Tosuni, se nëse nuk ndërmerr të gjitha hapat e nevojshëm për shmangien e konfliktit të interesit brenda afatit të paraparë Agjencia është e obliguar të veproj konform nenit 18 (paragrafi 8) te Ligjit Nr.04/L- 051.

Me datën 01.12.2016 nga zyrtari i lartë z. Gëzim Tosuni, kemi pranuar dëshminë se i njëjti ka dhënë dorëheqje nga funksioni i Dekanit të Fakultetit Ekonomik ne Universitetin “ Kadri Zeka” në Gjilan.

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga zyrtari i lartë z. Gëzim Tosuni, Dekan i Fakultetit Ekonomik në Universitetin “Kadri Zeka” në Gjilan janë krijuar rrethana të reja pasi qe i njëjti ka dhënë dorëheqje nga funksioni publik andaj konsiderojmë se me ket veprim është shmangur gjendja e mundshme e konfliktit të interesit dhe mospajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

